



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 72/6 prot.

Peshkopi, më 23.03.2022

VENDIM

Nr. 5 Datë 23.03.2022

PËR

**PROPOZIM PËR NDRYSHIM DESTINACIONI NGA FESTIVALI I KËNGËS DIBRANE
"JEHONA E ARBËRIT" NË FESTIVALIN KULTUROR "ZËRAT E RINJ TË KËNGËS
POPULLORE", QENDRA KULTURORE DIBËR.**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 82/1, pika b, Keshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 23.03.2022 pasi mori në shqyrtim Projekt Vendimin Nr. 5, datë 23.3.2022 të paraqitur nga Sektori Juridik dhe Projektëve dhe Sektori i Financës dhe pas diskutimit nga Anëtarët e Këshillit u miratua me 10 Vota Pro.

Në përfundim Këshilli i Qarkut Dibër

VENDOSI:

1. Miratim e propozimit të fondit për ndryshim destinacioni të miratuar me vlerë 500.000 lekë për Festivalin e Këngës Dibrane "Jehona e Arbërit", në Festivalin Kulturor "Zërat e rinj të këngës Popullore" Qendra Kulturore Dibër.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe i Projekteve dhe Sektori i Financës.
3. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. U shpall me dt. 23.03.2022

KRYETAR

Valentina HALITI



Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Të & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al